
	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare	
	<i>ver. 2.0</i>	<i>Faqe 1 nga 16</i>


Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimet e Kapaciteteve Ndër-Kufitare

Kjo procedurë e **Rregullave të Tregut** (përfshirë edhe amendamentimet pasuese) është përpiluar në përputhje me paragrafin 7.1.1 të **Rregullave të Tregut** dhe është përgatitë në përputhje me Nenin 24, paragrafi 6 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr.03/L -201).

	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare	
	<i>ver. 2.0</i>	<i>Faqe 2 nga 16</i>

PËRMBAJTJA

1	OBJEKTIVAT DHE FUSHËVEPRIMI.....	3
1.1	OBJEKTIVAT	3
1.2	FUSHËVEPRIMI.....	3
2	DEFINICIONET DHE SHKURTESAT	3
2.2	DEFINICIONET.....	3
2.3	SHKURTESAT	4
3	PËRGJEGJËSITË	4
3.1	KOSTT	4
3.2	PALËT TREGTARE	5
4	DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	5
5	ANKANDET E KAPACITETEVE INTERKONEKTIVE	7
5.1	ORGANIZIMI I ANKANDEVE TË KAPACITETEVE INTERKONEKTIVE.....	7
5.2	DORËZIMI I OFERTAVE TË ANKANDIT.....	9
5.3	VALIDIMI DHE VERIFIKIMI I OFERTAVE	10
5.4	KAPACITETI INTERKONEKTIV I FITUAR.....	11
5.5	REDUKTIMI I TË DREJTAVE PËR TRANSFERIN FIZIK (DTF) TË FITUARA	12
5.6	TRANSFERIMI I TË DREJTAVE PËR TRANSFERIN FIZIK (DTF)	13
6	NOMINIMI I TË DREJTAVE PËR TRANSFERIN FIZIK	14
7	SHTOJCË	15

	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare	
	<i>ver. 2.0</i>	<i>Faqe 3 nga 16</i>

1 Objektivat dhe Fushëveprimi

1.1 Objektivat

1.1.1 Kjo procedurë përcakton mënyrën e alokimit të Kapaciteteve Transmetuese në Disponim (KTD) në linjat interkonektive të Rrjetit Transmetues në Kosovë. Kjo procedurë përfshinë regjistrimin dhe ç'regjistrimin e Pjesëmarrësve në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive, në përputhje me Nenin 7 dhe Nenin 10 të Rregullave të Tregut, alokimin e KTD në kufijtë e Zonës Rregulluese të KOSTT, si dhe dispozitat për nominimin e Kapaciteteve Intekonektive.

1.2 Fushëveprimi

1.2.1 Kjo procedurë mbulon mënyrën në të cilën realizohet alokimi i KTD për vitin 2015 për kufijtë e Zonës Rregulluese të KOSTT të cilët nuk janë përfshirë në procesin e alokimit të organizuar nga SEE CAO.

1.2.2 Kjo procedurë nuk mbulon përkufizimin dhe kalkulimin e Kapaciteteve Transferuese Totale (TTC), Kapaciteteve Transferuese Neto (NTC) dhe Kapaciteteve Transmetuese në Disponim (KTD) për Zonën Rregulluese të KOSTT.

2 Definicionet dhe Shkurtesat

2.1.1 Të gjitha definicionet dhe shkurtesat në këtë dokument paraqesin definicionet dhe shkurtesat në Rregullat e Tregut.

2.1.2 Përveç këtyre, në këtë procedurë janë përdorur definicionet dhe shkurtesat vijuese:


2.2 Definicionet

Ankandi – Metodë bazuar në treg për të paraqitur ofertat për alokimin e kapacitetit transmetues ndërkufitar për kufi, drejtim dhe periudhë kohore të definuar paraprakisht.

Çmimi marginal – Çmimi i ofertës së fundit të pranuar gjatë një ankandi.

Mbajtësi i Të Drejtave për Transferin Fizik –Pjesëmarrësi në Ankand të cilit i është dhënë e drejta e shfrytëzimit të DTF apo një Pjesëmarrës në Ankand të cilit i është transferuar DTF.

Oferta e Ankandit – Oferta e paraqitur nga Pjesëmarrësi në Ankand me vlerë të definuar të kapacitetit të kërkuar dhe me çmim të ofruar për atë kapacitet (MW, EUR/(MWh)).

	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare	
	<i>ver. 2.0</i>	<i>Faqe 4 nga 16</i>

Pala Aplikuese – Pala e cila aplikon në KOSTT për tu regjistruar në Ankandet e kapaciteteve vjetore/mujore/ditore.

Procedura e Ankandit - Procedura e alokimit të të drejtave për shfrytëzimin e kapacitetit transmetues ndërkufitar.

Periudha e ankandit - Periudha me vlera të barabarta të Kapacitetit Transmetues në Disponim për të cilën alokimi i të drejtave për shfrytëzim bëhet përmes Ankandit. Mund të jetë një vit kalendarik, një muaj kalendarik ose një ditë.

Pjesëmarrës në Ankand - Palë Tregtare e cili në Ankand ka dorëzuar Ofertë për Ankand për alokimin e të drejtës për të shfrytëzuar kapacitetin, me kusht që më parë ka përmbyllur marrëveshje me KOSTT për blerjen dhe përdorimin e të drejtave të kapacitetit në kufijtë e Zonës Rregulluese të KOSTT.

Zona Rregulluese - Pjesë përbërëse e sistemit të ndërlidhur të ENTSO-E (për pjesën e Evropës kontinentale), të kontrolluar nga një operator i sistemit të transmetimit.

2.3 Shkurtesat

DTF – Drejta për Transferin Fizik

KTD – Kapaciteti Transmetues në Disponim

MKAK – Marrëveshja Kornizë për Alokimin e Kapaciteteve

SEE CAO – Zyra për Ankandin e Koordinuar në EJJL

SME – Sistemi për Menaxhimin e Energjisë


ZRRë – Zyra e Rregullatorit të Energjisë

3 Përgjegjësitë

3.1 KOSTT

KOSTT do të:

- (a) vë këtë procedurë në dispozicion të të gjitha Palëve Tregtare që dëshirojnë të fitojnë të drejtën për shfrytëzimin e KTD;
- (b) zbatojë këtë procedurë;

	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare	
	<i>ver. 2.0</i>	<i>Faqe 5 nga 16</i>

- (c) revidojë dhe azhurnojë këtë procedurë bazuar në modifikimet e rregulloreve ndërkombëtare për transferin e energjisë elektrike, si dhe ndryshimet në legjislacionin primar dhe sekondar në lëmin e energjisë elektrike.
- (d) pranojë, regjistrojë dhe analizojë aplikacionet për regjistrim dhe ç'regjistrim të Pjesëmarrësve në Treg që dëshirojnë të marrin pjesë në Ankandin e Kapaciteteve Interkonektive.
- (e) publikojë KTD në ueb-faqe të KOSTT për çdo periudhë të Ankandit para çdo Ankandi.

3.2 Palët Tregtare

Palët Tregtare që dëshirojnë të fitojnë të Drejtat për Transferin Fizik (DTF) duhet të:

- (a) dorëzojnë aplikimin për regjistrim për pjesëmarrje në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive,
- (b) ofrojnë të gjitha informatat e kërkuara nga KOSTT.
- (c) dorëzojnë Ofertat e Ankandit (çmimin dhe vlerën) tek KOSTT në përputhje me detyrat e tyre të definuara në Rregullat e Tregut dhe në këtë procedurë.
- (d) nominojnë vlerën e të DTF që do të përdorin, nëpërmes nominimeve të kapaciteteve.


4 Dispozitat e Përgjithshme

4.1.1 Kjo procedurë mbulon proceset vijuese:

- a) Regjistrimin dhe ç'regjistrimin e Palëve si Pjesëmarrës në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive
- b) Organizimin e Ankandeve të Kapaciteteve Interkonektive
- c) Transferi i DTF
- d) Nominimin e DTF të fituara në një Ankand të Kapaciteteve Interkonektive


4.1.2 Vetëm Palët Tregtare të cilët janë licencuar dhe kanë nënshkruar Marrëveshjen për Aderim në Rregullat e Tregut mund të marrin pjesë në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive.

4.1.3 Para se të marrin pjesë në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive, nga Palët Tregtare gjithashtu do të kërkohet të përmbyllin Marrëveshjen Kornizë për

	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare	
	<i>ver. 2.0</i>	<i>Faqe 6 nga 16</i>

Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive (MKAK) për Sistemin e Transmisionit në Kosovë e cila është e publikuar në ueb-faqe të KOSTT

- 4.1.4 Palët Tregtare që dëshirojnë të regjistrohen si Pjesëmarrës në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive duhet të dërgojnë kërkesën e tyre me shkrim tek KOSTT së paku 20 ditë pune para datës së parë të aktivitetit.
- 4.1.5 Palët Tregtare që dëshirojnë të regjistrohen duhet të përdorin Formularin për Regjistrim, i cili është i publikuar në ueb-faqe të KOSTT.
- 4.1.6 Pas pranimit të aplikacionit dhe brenda 5 (pesë) ditë pune nga data e pranimit të aplikacionit, KOSTT bën verifikimin e mjaftueshmërisë së informatave të dorëzuara nga aplikuesi.
- 4.1.7 Në qoftë se aplikacioni i dorëzuar është i pa kompletuar apo jo i saktë, KOSTT do të informojë Palën Aplikuese me e-mail. Nëse aplikuesi brenda një jave nuk dorëzon aplikacionin e kompletuar dhe të saktë, KOSTT do të konsiderojë se aplikacioni nuk është dorëzuar dhe nuk do ta marrë në konsideratë këtë aplikacion.
- 4.1.8 Në rast se aplikacioni i dorëzuar është i saktë dhe i kompletuar, KOSTT do t'ia dërgojë Palës Aplikuese MKAK me e-mail.
- 4.1.9 Pala Aplikuese e cili pranon MKAK është e obliguar ta nënshkruajë dhe vulosë atë dhe t'i dërgojë 5 kopje të MKAK te KOSTT.
- 4.1.10 Brenda 5 (pesë) ditë pune pasi ka pranuar MKAK të nënshkruar nga Pala Aplikuese, KOSTT do t'i nënshkruajë të pesë kopjet e marrëveshjes dhe dy nga ato do t'ia kthejë Palës Aplikuese.
- 4.1.11 MKAK do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga ana e KOSTT dhe Pala Aplikuese do të fitojë statusin e pjesëmarrësit në ankand i cili ka të drejtë të ;
- a) pjesëmarrjes në Ankand;
- b) bëjë transferin e DTF të fituara në ankand te pjesëmarrësit tjerë
- 4.1.12 KOSTT e aprovon kërkesën e Palës Aplikuese për regjistrim si Pjesëmarrës në Ankandin e Kapacitetit Interkonektiv si në vijim:
- (a) Jo më vonë se 15 Nëntori i vitit Y-1 me qëllim që të mund të marrë pjesë në Ankandin vjetor për vitin Y.
- (b) Jo më vonë se deri në ditën e parë të muajit M-1 me qëllim që të mund të marrë pjesë në Ankandin mujor për muajin M.

	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare	
	<i>ver. 2.0</i>	<i>Faqe 7 nga 16</i>

(c) Jo më vonë se dita e 15 e M-1 me qëllim që të mund të marrë pjesë në Ankandin ditor për muajin M.

4.1.13 Në rast se KOSTT vendosë të refuzojë një aplikacion për regjistrim, KOSTT do ta informojë menjëherë Palën Aplikuese, por jo më vonë se 5 ditë pune para datës së hyrjes në fuqi, dhe do ta arsyetojë refuzimin.

4.1.14 Palët Tregtare që dëshirojnë të ç'regjistrohen duhet të përdorin Formularin për ç'regjistrim, i cili publikohet në ueb-faqe të KOSTT.

4.1.15 Në qoftë se një Palë Tregtare nuk dëshiron më tutje të jetë e regjistruar si Pjesëmarrës në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive, duhet të informojë me shkrim KOSTT, jo më vonë se 30 ditë para Datës së Hyrjes në Fuqi të Tërheqjes.

4.1.16 Ç'regjistrimi i Pjesëmarrësit në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të ardhshëm kalendarik ose pas datës së kërkuar nga Pala Tregtare për tërheqje.

4.1.17 Palës Tregtare gjithashtu do ti ndërpritet e drejta për të qenë Pjesëmarrës në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive në qoftë se dështon ti plotësojë obligimet e veta sipas MKAK, me ç'rast regjistrimi do të de-aktivizohet në përputhje me dispozitat e Nenit 30 të asaj kontrate.

5 Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive

5.1 Organizimi i Ankandëve të Kapaciteteve Interkonektive


5.1.1 KOSTT është përgjegjës për koordinimin e përcaktimit të vlerave të kapaciteteve ndër-kufitare dhe harmonizimin e tyre me OST fqinjë.

5.1.2 Pas përcaktimit të kapaciteteve transferuese interkonektive për vitin e ardhshëm kalendarik, por së paku (2) muaj para fundit të vitit aktual, KOSTT do ti raportojë në ZRrE vlerat e propozuara të KTD, ndaras për çdo Interkoneksion dhe për çdo periudhë të Ankandit.


5.1.3 KOSTT do të publikojë në ueb-faqe të KOSTT vlerat aktuale të parashikuara të KTD për çdo kufi Interkonektiv dhe për çdo kah për vitin që vjen. Përveç kësaj, KOSTT do të publikojë vlerat e azhurnuara për muajin e ardhshëm, duke marrë parasysh çdo informatë të re të disponueshme.

5.1.4 KOSTT definon Periudhat e Ankandëve të Kapaciteteve Interkonektive. Këto periudha do të jenë periudha vjetore, mujore dhe ditore.

5.1.5 KOSTT do të bëjë alokimin e një pjese të KTD në interkoneksionet e tij dhe do të jetë përgjegjës për gjysmën e KTD total (50-50) përveç në qoftë se dakordohet ndryshe me operatorët e sistemeve transmetuese fqinjë.

	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare	
	<i>ver. 2.0</i>	<i>Faqe 8 nga 16</i>


- 5.1.6 Në bazë vjetore, KOSTT do të bëjë alokimin e KTD për të cilën është përgjegjës duke aplikuar metodën e Ankandit Eksplicit. Në rastet kur kalkulimet e rregullta mujore nuk i konfirmojnë vlerat e llogaritura vjetore, KOSTT do të mbajë të drejtën të reduktojë dhe anulojë kapacitetin transmetues të alokuar në ankandet vjetore si përcaktohet në Nenin 5.5 në këtë procedure dhe do të informojë ZRrE dhe shfrytëzuesit të cilëve tashmë u ishte alokuar kapaciteti.
- 5.1.7 Në baza mujore, KOSTT do të bëjë alokimin e KTD për të cilën është përgjegjës duke aplikuar metodën e Ankandit Eksplicit. KOSTT mund të bëjë rezervimin e një pjese të kapacitetit transmetues mujor për alokim ditor dhe duhet ti informojë pjesëmarrësit për këtë. KOSTT duhet ta informojë me kohë ZRrE për kushtet dhe veprimet e përkufizuara në paragrafin e më sipërm.
- 5.1.8 KOSTT do të organizojë Ankandet Eksplicite ditore për pjesën e mbetur të KTD që nuk është alokuar në ankandet mujore, apo që nuk është nominuar në D-2.
- 5.1.9 Kapacitetet interkonektive të pashfrytëzuara mund të alokohen në nivelin intra-day bazuar në principin ‘first come – first served’ me miratimin e dyanshëm të operatorëve të sistemeve transmetuese.
- 5.1.10 KOSTT mbanë të drejtën për rezervimin e një pjese të kapacitetit transmetues ndër-kufitar për të siguruar shërbimet e sistemit në Kosovë nga sistemet elektroenergjetike fqinje.
- 5.1.11 Vlerat vjetore të KTD, për të gjithë kufijtë dhe të gjitha kahjet të Zonës Rregulluese të KOSTT, do të publikohen jo më vonë se 2 javë para ditës së Ankandit.
- 5.1.12 Ankandet vjetore për vitin Y do të organizohen njëkohësisht për të gjithë kufijtë dhe kahjet jo më vonë se 2 Dhjetor të vitit Y-1. KOSTT publikonë në ueb-faqe e KOSTT datën e saktë dhe të gjitha informata në lidhje me Ankandin vjetor.
- 5.1.13 Kapaciteti inerkonektiv i alokuar në Ankandin vjetor aplikohet nga ora 00:00 e 1 Janarit, deri në orën 24:00 të 31 Dhjetorit.
- 5.1.14 Vlerat mujore të KTD për muajin M do të publikohen jo më vonë se 2 javë para ditës së Ankandit.
- 5.1.15 Ankandet mujore për muajin M do të organizohen njëkohësisht për të gjithë kufijtë, dhe për të gjitha periudhat e Ankandit jo më vonë se dita e 20 kalendarike e muajit M-1. KOSTT do të publikojë në ueb-faqe e KOSTT datën e saktë dhe të gjitha informata në lidhje me Ankandin mujor.
- 5.1.16 Kapaciteti inerkonektiv i alokuar në Ankandin mujor aplikohet nga ora 00.00 (CET) të ditës së parë të muajit të Ankandit deri në orën 24.00 (CET) të ditës së fundit të muajit të Ankandit.

	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare	
	<i>ver. 2.0</i>	<i>Faqe 9 nga 16</i>


- 5.1.17 Pas përfundimit të ankandit vjetor/mujor , çdo Pjesëmarrës në Ankand mund të shoh rezultatet përmes Sistemit për Menaxhimin e Energjisë për alokimin e kapaciteteve, jo më vonë se ora 17:00. Pjesëmarrësi në ankand do të ketë çasje vetëm në informatat lidhur me të dhe në informatat gjenerale
- 5.1.18 Pas përfundimit të ankandit vjetor/mujor, jo më vonë se brenda 5 (pesë) ditëve të punës, KOSTT do të publikojë në web-faqe një tabelë me të dhënat e përgjithshme rreth rezultateve të ankandit .
- 5.1.19 Vlerat ditore të KTD për ditën Ankandin ditor, do të publikohen jo më vonë se në orën 08:00 të ditës D-1.
- 5.1.20 Ankandet ditore do të organizohen njëkohësisht për të gjithë kufijtë, të gjitha kahjet dhe për të gjitha periudhat e Ankandit deri në orën 09:30 të D-1.
- 5.1.21 Pas përfundimit të Ankandit ditor, çdo Pjesëmarrës në Ankand mund të shoh rezultatet përmes Sistemit për Menaxhimin e Energjisë për alokimin e kapaciteteve , nga 10:00 të D-1.
- 5.1.22 KOSTT do të publikojë në ueb-faqe të gjitha informatat relevante për Ankandin ditor më së largu në orën 10:30.
- 5.1.23 Të gjitha ankandet do të organizohen nga KOSTT. Për çdo Periudhë të ankandit për çdo interkoneksion dhe për çdo kah do të organizohen ankande individuale.

5.2 Dorëzimi i Ofertave të Ankandit

- 5.2.1 Dorëzimi i Ofertave të Ankandit, si dhe pranimi i rezultateve pas kompletimit të Ankandeve vjetore, mujore dhe ditore do të realizohet vetëm nëpërmes –modulit të Sistemit për Menaxhimin e Energjisë për alokimin e kapaciteteve (këtu e tutje SME), të cilit Pala mund ti qaset nëpërmes adresës së publikuar në ueb-faqe të KOSTT [http:// www.kostt-mo.com /](http://www.kostt-mo.com/)
- 5.2.2 E drejta për tu qasur në SME mund të realizohet vetëm nga Pjesëmarrësit e regjistruar të cilët do të kenë një emër të shfrytëzimit dhe fjalëkalim për qasje në SME.
- 5.2.3 Në rast të mos disponueshmërisë të SME për alokimin e të drejtave të kapacitetit, ofertat do të dërgohen me faks apo e-mail në formën e cila është e publikuar në web faqe.
- 5.2.4 Ofertat e Ankandit në Ankandet vjetore dhe mujore dorëzohen tek KOSTT ekskluzivisht në periudhën nga ora 09:00 deri në orë 13:00 të ditës së publikuar në Kalendarin e organizimit të ankandeve në ueb-faqe të KOSTT si “dita për dorëzimin e Ofertave për Ankand”.

	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare	
	<i>ver. 2.0</i>	<i>Faqe 10 nga 16</i>

- 5.2.5 Ofertat e Ankandit në Ankandet ditore dorëzohen tek KOSTT ekskluzivisht në periudhën nga ora 09:00 deri në orën 09:30 të D-1.
- 5.2.6 Pjesëmarrësit në Ankandet për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive mund të fitojnë nëpërmes Ankandit të drejtën për shfrytëzimin e një pjese të KTD që korrespondon me kahjen në një kufi të caktuar dhe të alokuar në një periudhë të caktuar të alokimit vjetor ose mujor. Kahja e transaksionit interpretohet nga pikë vështrimi i sistemit të Kosovës.
- 5.2.7 Në Ankandet vjetore, mujore dhe ditore vlera e kapacitetit në Oferta të Ankandit, si dhe Kapaciteti i Alokuar nga ana e KOSTT paraqet kapacitetin me vlerë konstante në MW për çdo orë dhe gjatë tërë Periudhës së Ankandit.
- 5.2.8 Çdo Ofertë e Ankandit përmban një kod identifikues unik EIC (Energy Identification Code), në përputhje me kërkesat e ENTSO-E që i atribuohet Pjesëmarrësit në Ankand, datën dhe orën e regjistrimit të Ofertës së Ankandit dhe numrin e versionit.
- 5.3 Validimi dhe Verifikimi i Ofertave**
- 5.3.1 Palët pjesëmarrësit në ankandet vjetore dhe mujore mund të dorëzojnë maksimalisht 5 (pesë) Oferta.
- 5.3.2 Vlera minimale e kapacitetit në një Ofertë të Ankandit është 1 MW kurse vlera maksimale është 50 MW. Vlera e kapacitetit në një Ofertë të Ankandit duhet të jetë numër i plotë. Në raste specifike, kur KTD është më i vogël se 50 MW, vlera maksimale e kapacitetit në një Ofertë të Ankandit është e barabartë me vlerën e KTD.
- 5.3.3 Çmimi në Ofertë të Ankandit është i obligueshëm. Çmimi duhet të jetë në EUR/(MWh), me dy decimale, ku çmimi më i ulët në Ofertë të Ankandit duhet të jetë më i madh se zero, d.m.th. duhet të jetë minimum 0,01 EUR/MWh.
- 5.3.4 Në qoftë se shuma e kapaciteteve të kërkuara është më e vogël apo e barabartë me KTD, pra nuk ka kongestion, atëherë të gjitha Ofertat e Ankandit do të pranohen dhe çmimi për alokimin e kapacitetit në rast të transferit të energjisë elektrike është zero (0).
- 5.3.5 Në qoftë se shuma e kapaciteteve të kërkuara është më e madhe se KTD, pra ka kongestion, Ofertat e Ankandit renditen nga çmimi më i lartë kah çmimi më i ulët për çdo kufi dhe për çdo kah në interkonektorë.
- 5.3.6 Të gjitha Ofertat e Ankandit, deri në ofertën e cila e plotëson kapacitetin transferues të disponueshëm, janë oferta fituese.

	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare	
	<i>ver. 2.0</i>	<i>Page 11 nga 16</i>

- 5.3.7 Çmimi i ofertës së fundit paraqet çmimin e Ankandit, Çmimin Margjinal, që paguhet nga të gjithë Palët Pjesëmarrëse që kanë fituar të drejtën për shfrytëzimin kapacitetit.
- 5.3.8 Në qoftë se oferta e fundit e pranuar tejkalon vlerën e KTD të mbetur, Oferta e Ankandit do të pranohet brenda kufijve të KTD të mbetur. Në qoftë se ekzistojnë më shumë se një Ofertë e Ankandit me çmimin e fundit, atëherë kapaciteti i disponueshëm i mbetur do të ndahet proporcionalisht ndërmjet tyre.
- 5.3.9 Pjesëmarrësit në Ankand të cilët kanë fituar të drejtën për kapacitet janë të obliguar të paguajnë Pagesën për DTF sipas formulës vijuese.

$$PDTF = \sum_{j=1}^n (\text{ÇM}_j \cdot \text{KA}_j)$$

Ku:

PDTF - Pagesa për të Drejtat për Transferin Fizik


ÇM - Çmimi Margjinal për periudhën e barazimit përfundimtar *j*

KA - Kapaciteti i Alokuar për periodën e barazimit përfundimtar *j*

n - Numri periodave të barazimit përfundimtar

5.4 Kapaciteti Interkonektiv i Fituar

- 5.4.1 Palët Pjesëmarrëse në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive, Ofertat e Ankandit të të cilëve janë pranuar, fitojnë të drejtën për shfrytëzimin e DTF për tërë periudhën e Ankandit përkatës.
- 5.4.2 DTF e kontraktuar si dhe detyrimet për pagesa në lidhje me DTF duhet të paguhet për tërë periudhën e Ankandit, pa marrë parasysh rrjedhat e nominuara ose kapacitetin aktual në disponim. Pagesat për DTF të fituara në Ankandet Vjetore mund të bëhen në baza mujore vetëm pas arritjes së marrëveshjes me KOSTT.
- 5.4.3 Marrëveshja Kornizë për Kapacitetin Interkonektiv përcakton faturimin dhe afatet për pagesa si dhe obligimet.
- 5.4.4 E drejta për të shfrytëzuar DTF të kontraktuara në ankandet vjetore realizohet në periudhën nga ora 00.00 të Kohës së Evropës Qendrore (CET) të 1 Janarit– në orën 24.00 të 31 Dhjetorit (CET).

	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare	
	<i>ver. 2.0</i>	<i>Faqe 12 nga 16</i>

5.4.5 E drejta për të shfrytëzuar të Drejtat për Transferin Fizik të kontraktuara në ankandet mujore realizohet në periudhën nga ora 00.00 (CET) të ditës së parë të muajit të Ankandit deri në orën 24.00 (CET) të ditës së fundit të muajit të Ankandit.

5.4.6 E drejta për të shfrytëzuar DTF të kontraktuara në ankandet Ditore realizohet nga ora 00.00 (CET) deri në orën 24.00 (CET) të ditës së Ankandit.

5.5 Reduktimi i Të Drejtave për Transferin Fizik (DTF) të Fituara

5.5.1 KOSTT është i obliguar të bëjë të gjitha përpjekjet që të mundësoj realizimin DTF të alokuara në Ankandet vjetore, mujore dhe ditore.

5.5.2 Shfrytëzimi i DTF të fituara në Ankandet për Kapacitetet Interkonektive garantohet për kushtet normale në sistem.


5.5.3 Mbajtësve të DTF që duhet të shfrytëzojnë DTF të cilat u janë alokuar në cilindro kufi/kah në Ankandet vjetore mund të reduktohet shfrytëzimi i një pjese ose tërë DTF brenda një periudhe të caktuar kohore për shkak të shkyçjeve të planifikuara vjetore të linjave interkonektive ndër-kufitare për mirëmbajtje të rregullta, për shkak të Forcës Madhore ose për shkak të ngjarjeve tjera të paplanifikuara /të paparashikuara në sistemin elektroenergjetik.

5.5.4 Në rast të reduktimit të DTF të alokuara në Ankandin vjetor për shkak të shkyçjeve të planifikuara të linjave interkonektive për remonte të rregullta ose për mirëmbajtje, Mbajtësit e DTF do të njoftohen me kohë për vlerat e DTF që nuk mund të shfrytëzohen dhe për arsyet e këtyre kufizimeve, jo më vonë se në ditën e 12 të muajit M-1 për kapacitetin që do të shfrytëzohet në muajin M. Të gjithë Mbajtësit e DTF do të njoftohen para Ankandit të rregullt mujor për muajin M.

5.5.5 Në rast të reduktimit DTF të alokuara në Ankandin vjetor, për shkak të shkyçjeve të planifikuara të linjave interkonektive për remonte të rregullta ose për mirëmbajtje, Pagesën për të Drejtat për Transferin Fizik (PTDF) do të llogaritet pjesëmarrësit në ankand vetëm për atë periudhë kohore të muajit kur ajo mund të përdoret të drejtën e gjithë ose një pjesë të kapacitetit, dhe kjo është vetëm për kapacitetin maksimal që mund t'i përdoret.

5.5.6 Në rast të reduktimit të DTF të alokuara në Ankandin vjetor, mujor dhe ditor, për shkak të ngjarjeve të paplanifikuara në sistemin elektroenergjetik, përveç në rastin e Forcës Madhore KOSTT është i obliguar të kthejë PTDF brenda 15 ditësh nga dita e reduktimit të DTF. Kthimi i pagesës do të bëhet sipas çmimit marginal, për vlerën e kapacitetit të zvogëluar dhe për të gjitha orët kur DTF ishte reduktuar.

5.5.7 Kur bëhet reduktimi i KTD të gjitha Kapacitetet e Kontraktuara do të reduktohen proporcionalisht.

	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare	
	<i>ver. 2.0</i>	<i>Faqe 13 nga 16</i>

5.5.8 Pas kthimit të sistemit në kushtet e operimit normal, Pjesëmarrësit në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive do të informohen për këtë.

5.6 Transferimi i Të Drejtave për Transferin Fizik (DTF)

5.6.1 Pjesëmarrësi në Ankand, të cilit i janë alokuar DTF, nuk mund t'ia kthejë KOSTT-it një pjesë ose tërë DTF të alokuara, pa marrë parasysh arsyet për paaftësinë e tij për të shfrytëzuar Kapacitetin e Alokuar.

5.6.2 Pjesëmarrësit në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive mund ti transferojnë të drejtat e fituara në ankandet vjetore për shfrytëzimin e DTF. Transferi i këtyre të drejtave mund të bëhet për një pjesë apo për tërë kapacitetin e fituar. Në ankandet mujore, transferi mund të bëhet vetëm për periudhat një muajshe.

5.6.3 Mbajtësi i DTF mund të bëjë transferimin e kapacitetit në tërësi (vlera e plotë e DTF të alokuara për të gjitha orët e ditës) ose pjesërisht (për një pjesë për të gjitha orët e ditës), që do të thotë në vlerë të njëjtë për tërë ditën. Në qoftë se jo, KOSTT do ta anulojë një transferim të tillë.

5.6.4 Të gjitha obligimet legale dhe obligimet për pagesat që duhet ti bëhen KOSTT mbeten tek Mbajtësi i DTF fillestar.

5.6.5 Palët mund të transferojnë DTF duke tregtuar me palët tjera të regjistruara në KOSTT. Këto transferime duhet ti njoftohen KOSTT jo më vonë se dy ditë para mbylljes së tregut për Nominimet Interkonektive.


5.6.6 Transferimi i DTF mund të bëhet vetëm për të drejtat për kapacitet të alokuar në Ankandet vjetore ose mujore.

5.6.7 Transferimi i DTF mund të ekzekutohet më së voni deri në orën 12:00 tri ditë para ditës së parë të shfrytëzimit të së drejtës për kapacitet . Pas këtij afati të fundit transferimi i DTF nuk është i mundur.

5.6.8 Palës të cilit iu ka transferuar e drejta për shfrytëzimin e kapacitetit do të fitojë statusin e Mbajtësit të DTF.

5.6.9 KOSTT do të bëjë menjëherë verifikimin e Transferit të DTF në krahasim me Regjistrin e Kapaciteteve Interkonektive dhe do të:

- (a) refuzojë Transferin e DTF në qoftë se Mbajtësi i DTF fillestar nuk i ka kryer obligimet financiare për DTF ose
- (b) miratojë Transferin e DTF.

	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare	
	<i>ver. 2.0</i>	<i>Faqe 14 nga 16</i>

5.6.10 Në qoftë se KOSTT e refuzon një propozim për Transfer të DTF, ai do ta njoftojë sa më shpejt që është e mundur Palën propozuese të tregtimit duke dhënë arsyet për refuzim.

5.6.11 Pala të cilit DTF i është alokuar në alokimin një ditë-para (D-1), nuk mund të bëjë transferimin e DTF tek Pjesëmarrësit tjerë, d.m.th. në këtë rast nuk lejohet Transferi i DTF .

6 Nominimi i të Drejtave për Transferin Fizik

6.1.1 DTF të fituara në procedurën e Ankandit të ekzekutuar nga KOSTT ose nga operatorët e sistemeve transmetuese fqinje do të realizohet nëpërmes nominimeve të programeve të shkëmbimeve ditore në përputhje me Rregullat e Tregut.

6.1.2 Në procesin e nominimit të shkëmbimeve ndër-kufitare, KOSTT aplikon principin e bazuar në DTF të fituar.

6.1.3 Vlera e fuqisë së definuar në programin e shkëmbimit ndër-kufitar nuk guxon të tejkalojë vlerën e DTF.

6.1.4 Palët Tregtare do të realizojnë DTF të rezervuara gjatë alokimit të ekzekutuar nga KOSTT në mënyrë direkte nëpërmes nominimit të programeve të shkëmbimit ndër-kufitar.

6.1.5 Me qëllim të shfrytëzimit të DTF të fituar nga Ankandi vjetor apo mujor, Pala Tregtare duhet të dorëzojë një Nominim për Kapacitetin Transferues tek KOSTT në përputhje me kërkesat e KOSTT, jo më vonë se në orën 12:00 në (D-2).


6.1.6 Për të gjitha Nominimet e DTF të alokuara në baza Vjetor/Mujore të verifikuar me sukses, KOSTT do të dërgojë Aproximin e Nominimit të DTF deri në orën 12:30 të D-2.

6.1.7 Me qëllim të shfrytëzimit të DTF të fituar nga Ankandi ditore, Pala Tregtare duhet të dorëzojë një Nominim për Kapacitetin Transferues tek KOSTT në përputhje me Rregullat e Tregut, jo më vonë se në orën 13:00 në (D-1).

6.1.8 Të gjitha Nominimet e DTF do të dorëzohen nëpërmes sistemit elektronik dhe në formatin e definuar nga KOSTT.

6.1.9 Nominimet e DTF që janë në përputhshmëri me këto procedura do të bëhen Nominime të Miratuara të DTF.

6.1.10 Në qoftë se një Nominim i DTF nuk është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e kësaj procedure atëherë do të refuzohet nga ana e KOSTT dhe ky Nominim i Të Drejtave për Transferin Fizik do të shënjohe si i refuzuar.

	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare	
	<i>ver. 2.0</i>	<i>Faqe 15 nga 16</i>


6.1.11 Kur një Nominim i DTF të jetë refuzuar, KOSTT do ta njoftojë sa më parë që është e mundur palën që e ka dorëzuar këtë nominim.

6.1.12 Për të gjitha Nominimet e DTF të alokuara në baza ditore që janë verifikuar me sukses, KOSTT do të dërgojë Aprovimin e Nominimit të DTF deri në orën 14:30 të D-1.

7 Shtojcë

Afatet kohore nga Procedurat e Alokimit të kapaciteteve interkonektive:

Veprimet/Dokumentet	Pala Aplikuese D- Dërgimi P=Pranimi	KOSTT D- Dërgimi P=Pranimi	Afatet Së paku X ditë pune para datës së hyrjes në fuqi
Regjistrimi			
Dorëzimi i formularit për aplikim për regjistrim dhe ofrimi i autorizimeve të nevojshme	D	P	20
Validimi	P	D	5
Aprovimi/Refuzimi i aplikimit për regjistrim	P	D	5
Organizimi i Ankandeve të Kapacitetit Interkonektiv			
Njoftim lidhur me Ankandin Vjetor		D	2 javë para ditës së Ankandit
Njoftim lidhur me Ankandin Mujor		D	2 javë para ditës së Ankandit
Njoftim lidhur me Ankandin Ditor		D	Deri 08:00 të ditës së Ankandit
Mbyllja e Tregut për Dorëzimin e Ofertave të Ankandit për blerje Ankandin vjetor/mujor	D	P	13:00 në ditën e Ankandit
Mbyllja e Tregut për dorëzimin e Ofertave të Ankandit për Ankandin ditore	D	P	09:30 në ditën e Ankandit
Informatat për rezultatet e Ankandit, kapacitetet e fituara vjetor/mujor në SME	P	D	Deri 17:00 në ditën e Ankandit
Informatat për rezultatet e Ankandit, ditore në SME	P	D	Deri 10:30 në ditën e Ankandit
Transferi dhe Nominimi i Të Drejtave për Transferin Fizik (DTF) të alokuara në Ankandin vjetor/mujor/ditore			

	Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimin e Kapaciteteve Ndër-Kufitare		
	<i>ver. 2.0</i>		<i>Faqe 16 nga 16</i>

Dorëzimi i Njoftimit për Transfer të DTF	D	P	2 ditë pune para nominimit,(D-3)
Refuzimi/aprovimi Transferit të DTF	P	D	1 ditë pune para nominimit, (D-2)
Nominimi i Të Drejtave për Transferin Fizik DTF të alokuara në Ankandin vjetor/mujor	D	P	14:00 të D-2,
Aprovimi i Nominimit të DTF të alokuara në baza vjetore/mujore	P	D	15:30 të D-2,
Nominimi i Të Drejtave për Transferin Fizik DTF të alokuara në bazë ditore	D	P	13:00 të D-1,
Aprovimi i Nominimit të DTF të alokuara në baza ditore	P	D	15:30 të D-1,

(Fundi i Dokumentit)